REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3319/3 Prot

Rrëshen, më 01 . 10 . 2026

V E N D I M

Nr. 76 datë 25. 09. 2026
PËR
"MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË KRYETARIT TË BASHKISË MIRDITË, PËR EMËRIMIN E DREJTUESIT TË KULTURËS, ARTIT, MUZIKËS, ANSAMBLIT MIRDITA DHE QENDRËS KULTURORE", BASHKIA MIRDITË

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore në RSH-së", *i ndryshuar*, Kreu II nenet **8** dhe **9**, nenet **25** dhe **64**, Ligji nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar. Ligjin nr. 10352, datë 10.11.2010 "Për artin dhe kulturën", Kreu VI, nenet: 28 pika 1. Neni 30 pika 1 dhe 31. Ligjin nr. 35/2023 ''Për kopetencat e caktimit të pagave, trajtimeve të tjera financiare për përfitimet e të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi'' kreu II neni 6. Vendimin nr.127 datë.27.02.2026 ''për disa ndryshime në vendimin nr.425, datë 26.06.2024, të Këshillit të Ministrave, ''Për Miratimin e Strukturës dhe nivelet e pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo-mësimorë në Institucionet Arsimore dhe në Institucionet Plotësuese të Sistemit Arsimor Parauniversitar''. Vendimit nr. 98.dt.10.12.2025, të Këshillit Bashkiak Mirditë "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026, *konfirmimin* e Prefektit Qarkut Lezhë nr. 1240/4 prot, datë 22.12.2025, Vendimit të Këshillit Bashkiak Mirditë nr. 97, datë 10.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Mirditë për vitin 2026" konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë nr.1240/2, prot, Urdhërin nr. 32.datë 29.05.2026 ''Për Miratimin e Strukturës Organike të Bashkisë Mirditë - Institucioneve të Varësisë dhe Njësivë Administrative" Vendimeve të Këshillit të Ministrave në fuqi për strukturat, trajtimin financiar dhe pagat në njësitë e vetëqeverisjes vendore (përfshirë aktet nënligjore që parashikojnë klasifikimin e pozicioneve drejtuese të njësive vartëse/agjencive të bashkisë) *Relacioni nr. 3319/1 prot, datë 20. 07. 2026, nga (zyrat/sektorët përkatëse dhe Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë)*, dhe ***Deklarata nr. 4319 prot, datë 23.09.2026, e tërheqjes nga kandidimi i Z. Angjelo Gjoka***, së bashku me projekt-vendimin e Kryetarit të Bashkisë, pas diskutimeve në Këshillin Bashkiak;

V E N D O S I:

1. Miratimin e Propozimit, të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për emërimin e Drejtuesit të Kulturës, Artit, Muzikës, Ansamblit Mirdita dhe Qendrës Kulturore.

2. Kandidaturat e propozuara nga Kryetari i Bashkisë Mirditë janë: Z. Angjelo Agron Gjoka - Mastër i Arteve dhe Z. Andi Anton Shqalshi - Mastër i Arteve.

3. Kandidati i votuar nga Anëtarët e Këshillit Bashkiak është; Z. **Andi Anton Shqalshi**, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të Anëtarëve, **11** (*njëmbëdhjetë*) **vota**

4. Paga që do të trajtohet, Drejtuesi është në barazvlerë me "**Drejtor**" kategoria II-2 sipas VKM-ve në fuqi.

5. Për ndjekje dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

KRYETAR

Aleksandër PICAKU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3319/2 Prot. Rrëshen me, 20.07.2026

PROJEKT - VENDIM

Nr. 73, datë 10.07.2026

''Për Miratimin e Propozimit të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për emërimin e drejtuesit të Kulturës Artit - Muzikës - Ansamblit Mirdita dhe Qendrës Kulturore''

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore në RSH-së", i ndryshuar Kreu II nenet **8** dhe **9**, nenet **25** dhe **64**, Ligji nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar. Ligjin nr. 10352, datë 10.11.2010 "Për artin dhe kulturën", Kreu VI, nenet: 28 pika 1. Neni 30 pika 1 dhe 31. Ligjin nr. 35/2023 ''Për kopetencat e caktimit të pagave, trajtimeve të tjera financiare për përfitimet e të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi'' kreu II neni 6. Vendimin nr.127 datë.27.02.2026 ''për disa ndryshime në vendimin nr.425, datë 26.06.2024, të Këshillit të Ministrave, ''Për Miratimin e Strukturës dhe nivelet e pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo-mësimorë në Institucionet Arsimore dhe në Institucionet Plotësuese të Sistemit Arsimor Parauniversitar''. Vendimit nr.98.dt.10.12.2025, të Këshillit Bashkiak Mirditë "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026, konfirmimin e Prefektit Qarkut Lezhë nr.1240/4.prot datë 22.12.2025, Vendimit të Këshillit Bashkiak Mirditë Nr. 97, datë 10.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Mirditë për vitin 2026" konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë nr.1240/2.,prot, Urdhërin nr.32.datë 29.05.2026 ''Për Miratimin e Strukturës Organike të Bashkisë Mirditë - Institucioneve të Varësisë dhe Njësivë Administrative'' Vendimeve të Këshillit të Ministrave në fuqi për strukturat, trajtimin financiar dhe pagat në njësitë e vetëqeverisjes vendore (përfshirë aktet nënligjore që parashikojnë klasifikimin e pozicioneve drejtuese të njësive vartëse/agjencive të bashkisë) me propozim të Kryetarit të Bashkisë Mirditë.

Këshilli Bashkiak Mirditë

Vendosi:

1. Miratimin e Propozimit të Kryetarit të bashkisë Mirditë, për emërimin e drejtuesit të Kulturës Artit - Muzikës – Ansamblit Mirdita dhe Qendrës Kulturore.

2. Kandidaturat e propozuara nga Kryetari i bashkisë Mirditë janë: z.Angjelo Gjoka – Mastër i Arteve dhe z.Andi Shqalshi - Mastër i Arteve.

3. Kandidati i votuar nga këshilli është z._____ me _____ vota të vleshme.

4. Paga që do të trajtohet Drejtuesi është në barazvlerë me "**Drejtor**" kategoria II-2 sipas VKM-ve në fuqi.

5. Ngarkohet Kryetari Bashkisë për emërimin në detyrë dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ

KRYETAR

Aleksandër PICAKU

Paraqitën Projektin:

Përgjegjës i burimeve njerëzore
Viktor Gjoka

Përgjegjëse e Sektorit Juridik
Lorena Gjergji

Agjencia e Arsimit dhe Sporteve
Drejtor

Aurel Çupi

Sekretari i Përgjithshëm

ARTUR LAZRI

MIRATOI

KRYETARI I BASHKISË MIRDITË

ALBERT MËLYSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel &fax : +355 216 22233 web: www.bashkiamirdite.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KRYETARI

Nr 3319/1 Prot

Rrëshen më, 20.07.2026

RELACION

Për propozimin dhe emërimin e drejtuesit të Kulturës Artit - Muzikës – Ansamblit Mirdita dhe Qendrës Kulturore.

I-Qëllimi i projekt-vendimit

Ky projekt-vendim ka për qëllimin krijimin e një strukture të specializuar artistike pranë Bashkisë Mirditë, e cila do të ketë si objekt ruajtjen, promovimin dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe shpirtërore të krahinës së Mirditës. Bashkia Mirditë synon të jetë institucioni përfaqësues i vlerave folklorike, muzikore, koreografike dhe artistike të territorit të Bashkisë Mirditë, duke krijuar një identitet të qëndrueshëm kulturor në nivel vendor dhe kombëtar.

II. Baza ligjore

Projektvendimi mbështetet në:

- Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, veçanërisht nenet 8, 9, 25 dhe 64.
- Vendimin nr.127 datë.27.02.2026 ''për disa ndryshime në vendimin nr.425, datë 26.06.2024, të Këshillit të Ministrave, ''Për Miratimin e Strukturës dhe nivelet e pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo-mësimorë në Institucionet Arsimore dhe në Institucionet Plotësuese të Sistemit Arsimor Parauniversitar''
- Ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 ''Për artin dhe kulturën'', Kreu VI nenet 28. 30.31.
- Ligjin nr. 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike''.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak për miratimin e buxhetit të vitit 2026.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Mirditë për vitin 2026.
- Strukturën organizative të Bashkisë Mirditë të miratuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.
- Aktet nënligjore në fuqi që rregullojnë organizimin, funksionimin dhe trajtimin financiar të institucioneve të vetëqeverisjes vendore.

III. Argumentimi

Mirdita përfaqëson një nga zonat me traditën më të pasur folklorike, muzikore dhe etnografike në Shqipëri. **Bashkia Mirditë synon** ruajtjen e trashëgimisë kulturore, evidentimin dhe promovimin e artistëve vendas, pjesëmarrjen në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare. Zhvillimin e aktiviteteve kulturore gjatë gjithë vitit. Përfaqësimin dinjitoz të Bashkisë Mirditë në aktivitetet zyrtare.

Po ashtu, drejtimi i kësaj strukture për herë të parë nga një artist kompozitor krijon bazën institucionale për përfitimin e fondeve nga Ministria përgjegjëse për Kulturën, programet e Bashkimit Evropian, projektet ndërkufitare, fondacionet dhe donatorët ndërkombëtarë.

IV. Efektet financiare

Krijimi i strukturës nuk kërkon shtim të numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë përtej kufijve të miratuar. Shpenzimet për funksionimin e tij do të përballohen nga:fondet e miratuara në buxhetin vendor, të ardhurat nga aktivitetet artistike. Pozicioni i Drejtuesit të Ansamblit propozohet të trajtohet financiarisht në nivelin e ''Drejtorit'', sipas legjislacionit në fuqi.

V. Përfundime

Projekt-vendimi është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe krijon bazën ligjore për drejtimin dhe funksionimin e një institucioni të rëndësishëm kulturor, i cili do të kontribuojë në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor të Mirditës, si dhe në zhvillimin e jetës artistike dhe kulturore të komunitetit.Për sa më sipër, propozoj kandidaturën e **z.Andi Shqalshi** dhe **z.Angjelo Gjoka** për t'u miratuar nga këshilli njëri kandidat - sipas dakortësisë ose procedures së këshillit në pozicionin e punës ''Drejtues''si pozicion jashtë shërbimit civil, me marrëdhënie pune sipas Kodit të Punës.

Këshilli bashkiak ka të drejtën të dëgjoi platformën, idetë e secilit kandidat, që më pas të vendos nëpërmjet votës njërin prej tyre për postin e drejtuesit.

Të nderuar Anëtar të Këshillit bashkiak Mirditë: Kërkoj nga Ju, miratimin e këtij projekt-Vendimi, që Mirdita më së fundmi të jetë e përfaqësuar në aktivitete dhe veprimtari artistike dhe kulturore si Brenda vendit dhe jashtë vendit.

Faleminderit!

Paraqiten relacionin

Përgjegjës i burimeve njerëzore
Viktor Gjoka

Përgjegjëse e Sektorit Juridik
Lorena Gjergji

Agjencia e Arsimit dhe Sporteve

Drejtor

Aurel Çupi

Sekretari i Përgjithshëm

ARTUR LAZRI

MIRATOI

KRYETARI I BASHKISË MIRDITË

ALBERT MËLYSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KRYETARI

Nr 3319 Prot

Rrëshen më, 20.07.2026.

PROPOZIM

PËR KËSHILLIN BASHKIAK MIRDITË

Lënda: Për Propozimin e kandidaturës së z.Andi Shqalshi dhe z.Andi Gjoka për tu votuar dhe zgjedhur nga këshilli njëra kandidaturë si Drejtues të drejtuesit të Kulturës Artit - Muzikës – Ansamblit Mirdita dhe Qendrës Kulturore.

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore në RSH-së", i ndryshuar Kreu II nenet **8** dhe **9**, nenet **25** dhe **64**, Ligji nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar. Ligjin nr. 10352, datë 10.11.2010 "Për artin dhe kulturën", Kreu VI, nenet: 28 pika 1. Neni 30 pika 1 dhe 31. Ligjin nr. 35/2023 ''Për kopetencat e caktimit të pagave, trajtimeve të tjera financiare për përfitimet e të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi'' kreu II neni 6. Vendimin nr.127 datë.27.02.2026 ''për disa ndryshime në vendimin nr.425, datë 26.06.2024, të Këshillit të Ministrave, ''Për Miratimin e Strukturës dhe nivelet e pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo-mësimorë në Institucionet Arsimore dhe në Institucionet Plotësuese të Sistemit Arsimor Parauniversitar''. Vendimit nr.98.dt.10.12.2025, të Këshillit Bashkiak Mirditë"Për miratimin e buxhetit të vitit 2026, konfirmimin e Prefektit Qarkut Lezhë nr.1240/4.prot datë 22.12.2025, Vendimit të Këshillit Bashkiak Mirditë nr.97, datë 10.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Mirditë për vitin 2026" konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë nr.1240/2.,prot, Urdhërin nr.32.datë 29.05.2026 ''Për Miratimin e Strukturës Organike të Bashkisë Mirditë - Institucioneve të Varësisë dhe Njësive Administrative''Vendimeve të Këshillit të Ministrave në fuqi për strukturat, trajtimin financiar dhe pagat në njësitë e vetëqeverisjes vendore (përfshirë aktet nënligjore që parashikojnë klasifikimin e pozicioneve drejtuese të njësive vartëse/agjencive të bashkisë).

PROPOZOJ

1 Kandidaturën e z.Andi Shqalshi ose z.Angjelo Gjoka për tu miratuar nga këshilli njëri kandidat - sipas dakortësisë ose procedurës së këshillit në pozicionin e punës: Drejtues i Kulturës Artit - Muzikës – Ansamblit Mirdita dhe Qendrës Kulturore, pozicion jashtë shërbimit civil, me marrëdhënie pune sipas Kodit të Punës.
2 Miratimin e trajtimit financiar të këtij pozicioni në nivel të barabartë me pozicionin ''Drejtor'', sipas legjislacionit në fuqi II-2.

3 Ngarkimin e Kryetarit të Bashkisë për nxjerrjen e akteve administrative të nevojshme për organizimin, funksionimin dhe emërimin e drejtuesit të kulturës dhe artit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4 Ngarkimin e Drejtorisë së Financës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
5 Ky projekt–vendim është konceptuar që të jetë në koherencë me ligjin nr. 10352/2010 ''Për artin dhe kulturën", mbi institucionet/veprimtaritë artistike, në ligjin nr. 139/2015 ''për vetëqeverisjen vendore'' I ndryshuar dhe me kornizën e pagave sipas VKM-ve në fuqi.

Paraqitën Projektin:

Përgjegjës i burimeve njerëzore
Viktor Gjoka

Agjencia e Arsimit dhe Sporteve

Drejtor

Aurel Çupi

Sekretari i Përgjithshëm

ARTUR LAZRI

Përgjegjëse e Sektorit Juridik
Lorena Gjergji

MIRATOI

KRYETARI I BASHKISË MIRDITË

ALBERT MËLYSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

europass

Europass Curriculum Vitae

Informatat Personale

Mbiemri / Emri	Andi Shqalshi
Numri Personal i ID:	J00218051K
Adresa	Robert Shvarc, Nd.39, H.17. Ap 9, Njësia Administrative nr.5
Telefoni	0692159889
E-mail	Hitmanbeatz90@gmail.com
Nacionaliteti	Shqiptar
Data dhe vendi i lindjes	18.02.1990 Rrëshen, Mirditë
Gjinia	Mashkull

Eksperiencat e punës

Data	2011- aktiv
Pozita që është ushtruar	Producent, Kompozitor
Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë	Krijimi i këngëve,instrumentist (piano,firzamonikë), orkestrues, akustikant dhe masterizues
Emri dhe adresa e punëdhënësit	2BRentertainment
Lloji i biznesit ose sektorit	Muzikë

Edukimi

Pedagogji Muzikore (Master)
"Universiteti i Arteve" Tiranë
2018 - 2019

Pedagogji Muzikore (Bachelor)
"Universiteti Arteve" Tiranë
2010 – 2018

Shkolla e mesme
Liceu artistik " Jordan Misja "
2004 – 2008

Gjuha amtare: Shqip

Vetë – vlerësimi
Sipas nivelit europian (*)

	Të kuptuarit			Të folurit			Shkrimi
	Dëgjimi		Leximi	E folur interaktive		E folur produktive	
Anglisht	B1	Shumë mirë	B1 Shumë mirë	B1	Shumë mirë	B1 Shumë mire	B1 Shumë mirë

(*) *Korniza e përbashkët evropiane e referencës për gjuhët*

Aftesitë shoqërore	Kam aftësi të mira komunikuese, mund t'i shpreh qartë dhe saktë idetë e mia. Shpesh kam ide inovative dhe kam dëshirën ti bëj ato fakte me detaje. Përshtatem dhe kam një vetëvlerësim të fortë, më pëlqen të bëjë më të mirën në detyra që marr.
Aftesitë organizative	Kam aftësi të mira për administrimin e kohës, punoj mirë nën presion dhe zgjidh situata të komplikuara në qetësi. Jam i aftë të përfundoj atë që marr përsipër të bëj.
Aftesite kompjuterike	Zotëroj aftesi të mira në Microsoft Office, Adobe, Microsoft Exel.
Aktivitete muzikore	Drejtimi i disa akriviteteve artistike të shkollës së mesme Pashko Vasa në qytetin e Rrëshen-it Mirditë, pjesë e stafit drejtues në trajnimin dhe përgatitjen e nxënësve për zhvillimin e koncerteve të ndryshme. Kam qënë pjesë në "Mirdita Fest" 2015 si anetarë jurie në përzgjedhjen e talenteve të rinjë në muzikë. Në vitin 2017 me rastin e shënjterimit të Nënë Terezës kam trajnuar korine e Kishës Rrëshen për realizimin e këngës "Nënë Tereza " ku roli im ka qënë kompozimi, orkestrimi dhe realizimi me sukses pranë ambjenteve të 2BR studio. Numëroj mbi 30 kënge te kompozuara nga unë ne zhanere të ndryshme me pjësmarrje të këngëtarëve të ndryshëm dhe profesionistë si: Rovena Dilo, Era Rusi, Eranda Libohova, Rolla, etj. Kam marrë pjesë në festivale të ndryshme si "Kënga Magjike", "Zambaku i Prizërenit" etj. Pjesëmarrjet janë si më poshtë : Hit Fest RTSH 2012 - Grupi Opium "Lufto për Lumturinë" (kompozitor) Kënga Magjike 2014 – Hit-Man & Rolla "Five Stars" Kënga Magjike 2015 – Ardita & Armela "Asaj" (kompozitor) Kënga Magjike 2015 – Alex "Zemres qe s'me do" (kompozitor) Kënga Magjike 2016 – Hit-Man & Rolla "Thyje Thyje" Kënga Magjike 2019 – Rovena Dilo ft Hit-Man & Rolla "Cinderella" Zambaku i Prizërenit 2021– Rovena Dilo "Medusa" (kompozitor) kënga fituese e çmimit të parë edicioni 32. Gjithashtu janë realizur këngë të tjera si: Era Rusi ft Hit-Man & Rolla "Prej Meje", Fran Vorfi ft Hit-Man & Rolla "Oj Mollë e Kuqe", Rovena Dilo Eranda Libohova ft Hit-Man & Rolla "Mos më Lësho" etj, ku dhe janë klasifikur në 10-shen më të mirë në Top Awards. Festivali i 61-të në RTSH – Rovena Dilo "Molit" e vlerësuar me çmim. Eraldo, Irma, Eranda, Rovena, Era, Eneda, Mariza, Jonida, Hit Man & Rolla – "December to Remember" ... edhe shumë e shumë kompozime, orkestrime, produksione të tjera.



Europass
Curriculum Vitae

Informacion Personal

Emri /Mbiemri	Angjelo GJOKA
Adresa	Rruga "Arbrit", pall. nr 17, hyrja 3, kati I – rë, Rrëshen, 4601, B. Mirditë
Celular	**+355 (69) 479 2996**
E-mail	angjelo_gjoka@hotmail com
Data e lindjes	11.01.1992
Vendlindja	Elassona, Greqi

Eksperiencat e punësimit

Punësimi i dëshiruar

Inspektor në QKF pranë Bashkisë Mirditë

Arsimi

Data	09.2006 – 07.2010 **Shkolla e Mesme Artistike "Prenk Jakova", Shkodër** **Specialisteti: Fizarmonikë**
Data	09.12.2011 – 05.07.2014 **Universiteti Kristal** **Fakulteti i Muzikës** **Bachelor** **Dega "Kompozicion"**
Data	10.2019 – 07.2021 **Universiteti i Arteve, Tiranë** **Fakulteti i Muzikës** **Mastër Profesional** **"Pedagogji muzikore dhe mësuesi"**

Trajnimet	
Data	01.2020 – 03.2020
Emri i institucioni	Shkolla "Servete Maci" Tirane
Data	01.2021 – 03.2021
Emri i institucioni	Shkolla " 4 Dëshmorët" Tirane

Gjuhë të tjera

Vetëvlerësimi

Niveli Europian(*)

	Të kuptuarit		**Të folurit**		**Të shkruarit**
	Dëgjim	Lexim	Ndërveprim folës	Prodhim folës	
Anglisht	Mirë	Mirë	Mirë	Mirë	Mirë
Italisht	Shkëlqyer	Shkëlqyer	Shkëlqyer	Sh.mirë	Sh.mirë

Aftësi sociale dhe kompetenca	Aftësi shumë të mira organizative, komunikim shumë korrekt si dhe përkushtim në arritjen e objektivave të punës.
Aftësi teknike dhe kompetenca	Kam aftësi në përdorimin e produkteve muzikore, si dhe jam i aftë të eksploroj për të gjetur zgjidhje dhe në raste të veçanta.
Aftësi kompjuterike dhe kompetenca	Aftësi kompjuterike në programim, si përdorimin softeve të ndryshme si, Paketa Microsoft Office, **electro – acustic music, Cubase, Finale etj…**
Të tjera	**Patentë e klasit "B"**

Nr. 4319 Prot
Dt. 23.09.2026

DEKLARATË PËR TËRHEQJE NGA KANDIDIMI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – SEKRETARIA BASHKIAKE MIRDITË

Drejtuar: Komisionit të Vlerësimit dhe Përzgjedhjes për pozicionin e Drejtuesit te Kultures artit dhe Muzikes _ansamblit Mirdita dhe Qendres Kulturore.

Keshillit bashkiak Mirdite- Komisionit te Arsimit Sportit dhe Turizmit

Per dijeni . Burimeve njerezore

Lënda: Tërheqje nga kandidimi

Unë, **Angjelo Gjoka**, i regjistruar si kandidat në procedurën e konkurrimit për pozicionin **Drejtuesit te Kultures artit dhe Muzikes _ansamblit Mirdita dhe Qendres Kulturore**, bazuar në legjislacionin në fuqi për artin dhe kulturën, si dhe në të drejtën time për të hequr dorë nga pjesëmarrja në procedurën e konkurrimit,

Deklaroj se tërhiqem vullnetarisht nga kandidimi për këtë pozicion, duke kërkuar që emri im të mos merret më në konsideratë në vijim të procedurës së përzgjedhjes.

Kjo tërheqje bëhet me vullnet të lirë dhe pa asnjë rezervë, duke filluar nga data e paraqitjes së kësaj deklarate.

Ju lutem të kryeni veprimet administrative përkatëse dhe të pasqyroni tërheqjen time në dokumentacionin e procedurës.

Faleminderit për mirëkuptimin.

Deklaruesi Angjelo Gjoka

Angjelo Gjoka

Nënshkrimi: _____

23/09/2026